



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIK MALLAKASTËR

Ballshinë, 23.12.2025

PROCESVERBAL

I mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Mallakastër. Kryesues i mbledhjes është Z. Nexhmi Sulaj. Ora e mbledhjes: 13:00. Kryesuesi i mbledhjes deklaroi kuorumin prej 13 anëtarësh. Të pranishëm nga administrata: Znj. Etilda Dishaj, Z. Fitim Bare, Z. Aleksandër Rama, Znj. Kleidja Hoxhaj, Z. Besmir Selami, Z. Guri Nuhaj.

Kryetari i Këshillit e hap mbledhjen me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes më datë 21.11.2025.
3. **Projektvendim Nr.45:** Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.
4. **Projektvendim Nr.46:** Për miratimin e listës së përfituesve të bursave për nxënësit që ndjekin vitin e parë në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin shkollor 2025-2026.
5. **Projektvendim Nr.47:** Për miratimin e listës së përfituesve të bursave për nxënësit që ndjekin arsimin në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2025-2026.
6. **Projektvendim Nr.48:** Për miratimin e pagës së punonjësve mësimor efektiv (instruktur) në shkollat e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët që kryejnë orë mësimi shtesë, Bashkia Mallakastër.
7. **Projektvendim Nr.49:** Për miratimin e performancës të vitit 2025.
8. **Projektvendim Nr.50:** Për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe të buxhetit vjetor 2027.
9. **Projektvendim Nr.51:** Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Mallakastër dhe institucioneve në varësi për vitin 2026.
10. **Projektvendim Nr.52:** Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe deleguara për vitin 2026.
11. **Projektvendim Nr.53:** Për miratimin e buxhetit të vitit 2026, dokumentit përfundimtar të projektbuxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe numrit të përgjithshëm të punonjësve.
12. **Projektvendim Nr 54:** Për miratimin e financimit të ndarë në tre vite.

Kush është dakord me këtë rend dite? Votojnë 13 pro, asnjë kundër, asnjë apstenim. Miratohet.

Kalojmë te pika 2, sekretare të lutem na bëj me dije vendimet nga procesverbali i mbledhjes së kaluar.

1. **VENDIM NR.39:** Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.

**2. VENDIM NR.40:** Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026.

**3. VENDIM NR.41:** Për miratimin e kompensimit të shpenzimeve të transportit për nxënësit për vitin shkollor 2025-2026.

**4. VENDIM NR.42:** Për miratimin e fillimit të procedurave të privatizimit të pasurisë me Nr. 3/70+1-16, apartament, ZK 1090, Lagjia "18 Prilli", Ballsh, Bashkia Mallakastër

Vazhdojmë me rendin e ditës, pikën 3: Përmiratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%. Ka ndonjë nga ju pyetje, fjala për ju.

Z. Adrian Hazizaj: Para tre muajsh, kanë aplikuar tri familje nga Njësia Administrative Ngraçan, pse nuk janë paraqitur apo janë skualifikuar?

Znj. KleidjaHoxhaj: Në fakt duhet bërë verifikime me emër mbiemër, por mund të jenë dhe të lista tjetër.

Znj. Lindita Ymeraj: Sipas VKM-së së re për shpërblim bonus për familjet në nevojë, përfshihen këto të 6 %? I shtohen dhe tre anëtar mbledhjes, duke shkuar numri në 16.

Z. Qerim Ismailaj: Jemi në pritje të zbardhjes së atij vendimi, por 6%-shi nuk është pjesë e përfitim, por jemi në pritje, mund të ndodh si vjet dhe ju thërraim prap në një mbledhje jashtë radhe, kur të kemi dokumentin zyrtar

Me qën se s'ka diskutime të tjera e hedhim me votim, votojnë 16 pro, asnjë kundër, asnjë apstenim. Miratohet.

Kalojmë në pikën katër të rendit të ditës. Projektvendim Nr.46: Për miratimin e listës së përfituesve të bursave për nxënësit që ndjekin vitin e parë në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin shkollor 2025-2026, duhet t'ju bëjmë me dije që përveç emrave që keni në list janë dhe dy nxënës shtesë, mqs kanë sjellë dokumentacionin mbasi është dërguar projektvendimi.

Z. Nertil Sakaj: Në list janë pasqyruar të gjithë emrat e nxënësve që kanë sjellë dokumentat, nëse do ketë të tjerë shtesë ne i mirëpresim.

E hidhet në votim; votojnë 16 pro, asnjë kundër, asnjë apstenim, miratohet.

Atëherë kalojmë në votim të gjithë paketës, pra të projektvendimit; votojnë 14 pro, 0 kundër, 0 apstenim. Miratohet.

Z. Nexhmi Sulaj: Kalojmë në pikën pesë të rendit të ditës. Projektvendim Nr.47: Për miratimin e listës së përfituesve të bursave për nxënësit që ndjekin arsimin në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2025-2026.

Z. Klodjan Shehaj: Si është vepruar për këtë list? Sepse mendoj që dhe ne si drejtor shkollash duhet të ishim informuar dhe t'ju dërgonim një informacion në lidhje me nxënësit në vështirësi që frekuentojnë shkollat tona.

Z. Nertil Sakaj: Bëhet afishimi publik dhe në faqen ëeb, gjithashtu i dërgohet dhe zyrës vendore arsimore.

Z. Qerim Ismailaj: Këto janë fonde të deleguara nga M. Arsimit, janë 21 kuota, janë për të gjithë ciklet e arsimit, kush fëmijë është me përkrahje ose më një prind.

Z. Përparim Bengaj: Duhet pasur informacione shtesë, që të kenë mundësi për të fituar ata që realisht kanë nevojë.

Z. Qerim Ismailaj: E kuptoj shqetësimin tuaj, por nuk bëjmë dot shtim të rrethit të përfituesve, sygjerimi im është që nga të gjithë ata që aplikojnë, të përfitojnë ata më në nevojë.

Z. Lefter Rabiaj: Po përfituesit e ekselencës për klasën e nëntë?

Z. qerim Ismailaj: Kjo kalohet një herë në tre muaj, dhe e keni dhe si zë në buxhet për 2026-ën.

Znj. Lindita Ymeraj: Duhet të vlerësohet më mirë informacioni, që të përfitoj vërtetë ai që ka nevojë, jo u paraqitën 10 dhe këta 10 u futën në listë.

Z. Qerim Ismailaj: Burimi i informacionit nuk ka munguar, është bërë afishimi. Ti Klodi ke të drejtë kur thua që ti njeh nxënësit e shkollës tënde dhe Lindita nxënësit e shkollës së saj.

Z. Klodjan Shehaj: Nëse një prind bën kërkesë më vonë, a hyn në listë ai nxënës?

Z. Nertil Sakaj: Nuk të jap dot një përgjigje të sakt për momentin.

Z. Nexhmi Sulaj: Jeni të mendimit që ky projektvendim të kalojë, dhe më pas të bëhen shtesa?

E hedhim në votim; votojnë 16 pro, 0 kundër, 0 apstenim, miratohet.

Kalojmë në pikën gjashtë. Projektvendim Nr.48: Për miratimin e pagesë së punonjësve mësimor efektiv (instruktur) në shkollat e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët që kryejnë orë mësimi shtesë, Bashkia Mallakastër.

g. Z. Lefter Rabiaj: Më shumë paguhen orët jashtë mësimit se orët në shkollë.

Z. Qerim Ismailaj: është e sanksionuar nga M.Arsimit.

Z. Lefter Rabiaj: Nuk ka orë pune 3000 lekë.

Z. Qerim Ismailaj: Nuk është pagesë për orë pune, por shpërbëlim për orët shtesë.

Hidhet në votim; votojnë 16 pro, 0 kundër, 0 apstenim, miratohet.

Z. Nexhmi Sulaj: vazhdojmë me projektvendimin e radhës, pika shtatë e rendit të ditës; Për miratimin e performancës të vitit 2025.

Z. Lefter Rabiaj: Ju përgëzoj për punën e mirë që keni bërë, por një kërkesë kam unë për linjat urbane.

Z. Qerim Ismailaj: Nuk kemi linjë për Ballsh-Fier sepse operojnë taksi, kushdo subject që të paraqitet për këtë qëllim, për ne s'ka asnjë pengesë, do të jetë i mërëpritur. Jemi në 15 –shen e parë në rang vendi, kjo është e ndarë në fusha të ndryshme, treguesit financiar i ka positive.

E hedhim në votim, votojnë 16 pro, 0 kundër, 0 apstenim, miratohet.

Kalojmë në pikën tetë të rendit të ditës; Projektvendim Nr.50: Për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe të buxhetit vjetor 2027.

Z.Aleksandër Rama: Janë të përcaktuara afatet nga M.Financave, të cilat janë të lidhura me afatet ligjore sipas sistemeve. Datat janë të përcaktuara.

E hedhim ne votim, votojnë 16 pro, 0 kundër, 0 apstenim, miratohet.

Z. Nexhmi Sulaj, kalojmë në pikën nëntë, Projektvendim Nr.51: Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Mallakastër dhe institucioneve në varësi për vitin 2026.

Z. Qerim Ismailaj: Në lidhje me dëgjesat publike dhe konsultimet, por dhe sipas ligjit për ndarjen teritoriale B.Mallakastër ka Njësi Administrative. Komisioni i reformës teritoriale e ka parë të arsyeshme që Bashkia Mallakastër sa është e aftë të menaxhoj pastrimin në zonat përreth, dhe shërbime të tjera. Si Njësi Administrative teritoriale janë të përcaktuara me ligj, kurse nga ana administrative është menduar hapja e dy njësisive të tjera, Hekal dhe Aranitas, në një të 15 dhe tjetër të 13 punonjës.

Z. Adrian Hazizaj: Pse pikërisht këto dy njësi?

Z. Qerim Ismailaj: Është menduar për pjesën e largësisë nga bashkia këtu dhe për të ofruar shërbim sa më pranë qendrës së banimit për qytetarët. Në total e numrit të përgjithshëm të punonjësve janë vetëm katër punonjës shtesë. E kemi mbajtur në minimum për të pasur sa më pak shpenzime, dhe në pjesën e të ardhurave si paga. Kjo është menduar në fillim si projekt, për të parë se sa produktivitet do të japin këto administrate. Fshati Kutë i ka të zgjidhura këto nevoja, Ngraçani është afër me bashkinë, po ashtu dhe Greshica. P.sh kemi shkolla që mund të jenë me dhjetë nxënës, dhe për këto shkolla ka nga një sanitare, me orë të pjesëshme, dhe këto do jenë dhe për njësitë. Jemi munduar të ruajmë balancat e buxhetit, plus duhet të dini që disa pozicione janë të lëna pa punonjës.

Z. Adrian Hazizaj: D.m.th është shtesë; dy administratorët, dakord jemi ne.

Z. Qerim Ismailaj: Janë planifikuar dhe mirëmbajtësit e shkollave e kopshteve. Funkcionet e tranferuara janë të miratuara nga ministritë përkatëse, madje dhë pagat.

Z. Lefter Rabiçaj: hapja e këtyre dy njësisive bëhet për shërbim të munguar apo të cunguar dhe sa dotë jetë përfshirja financiare në këto dy ndryshime. Kur ndryshon struktura duhet të na i paraqisje me projektvendim, sipas censusit nr i popullsisë është në rënie, nuk e di cila do të jetë e mira e hapjes së këtyre dy administrative, dhe ku qëndron efekti financiar. Në Hekal ka qën administrate dhe u pa e arsyeshme të mbyllej, është vërtetë për shërbim të mirë apo ka pikëpyetje të tjera nga mbas?

Z. Qerim Ismailaj: Në sensing e funksionimit të të punëve nuk ka munguar, kam pasur dilemat e mia, arsyeja e hapjes së administrative t'i shpjegova më lart, që është për arsye të lehtësimit të qytetarëve. Efekti financiar është mbuluar, rritja e pagës nga qëndrorja nuk ka shumë ndryshime në të ardhurat e bashkisë.

Z. Lefter Rabiçaj: Pagat duhet Ndryshuar sipas rritjes që u bë për pagën minimale, si u fol me ligj.

Z. Qerim Ismailaj: Do të flasim për pjesën e pagave në projektvendimin tjetër. Efekti financiar është minimal, sepse nëse themi 14 punonjë në Njësinë Administrative Aranitas, këta janë pjesë të administratës së bashkisë. Kemi menduar dhe për pjesën tjetër, që për ne është shumë e ndjeshme, sepse ne kemi konflikte për pronat, dhe është më mirë të trajtohen sa më afër.

Z. Bejkush Haxhiaj: Në Nj.Adm Fratar si janë pozicionet e punës?

Z. Qerim Ismailaj: Kërtu janë të përmbledhur, por t'i shoh sipas strukturës, mund t'ua vë në dijeni.

Z. Bejkush Projektvendim Nr.52: Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Mallakastër, institucioneve në varësi, funksioneve të transferuara dhe deleguara për vitin 2026.

Z. Bejkush Haxhiaj: në këtë projektvendim është parashikuar ndryshimi i VKM-së, dhe në të njëjtën VKM një administrator e ka pagën 140 mijë dhe dy të tjerët 110 mijë lekë?

Z. Qerim Ismailaj: Është përlllogaritur vetëm një shtesë prej 5 mijë lekësh dhe do ti ndryshojmë në janar sepse do të ndryshoj paga minimale, por me efekt financiar nuk është parashikuar. Pagat e pushtetit lokal nuk janë fikse, ka një diapazon, paga e administratorit varion, Fratari ka më shumë punonjës dhe tre Njësi Administrative në varësi, kurse Hekali dhe Aranitasi nuk kanë të njëjtën ngarkesë puna.

Z. Bejkush Haxhiaj: Të paguhen në mënyrë të barabartë, që të mos bëhen dallime për të njëjtin vend pune, sepse ky dallim është i tepruar.

Z. Lefter Rabiçaj: Numri i banorëve në Njësin Fratar është më i madh se në Hekal dhe Aranitas.

Z. Qerim Ismailaj: Ka një llogjikë të thjeshtë fare, ai përfaqëson kryetarin e bashkisë, por dikush që mbulon një territory tre herë më të madh nuk mund të paguhet njësoj me si ai që s'ka të njëjtën ngarkesë pune. I thonë 60 mijë lekë shtesë në muaj o Bejkush, po i çua, m nga 140 të tre. E vlerësoj qëndrimin tënd.

Projektvendim Nr.53:Për miratimin e buxhetit të vitit 2026, dokumentit përfundimtar të projektbuxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe numrit të përgjithshëm të punonjësve.

Z. Aleksandër Rama: jemi fokusuar kryesisht te investimet, janë marr taksat dhe tarifat që u miratuan në muajin nëntor. Bashkia ka 13 programe dhe pasqyrohen në buxhet. Janë reflektuar kërkesat e qytetarëve gjatë dëgjësive publike dhe kërkesa e ardhur nga Aleanca e Grave Këshilltare për instalimin e kamerave në ambjentet publike. Shpenzimet ndahen në tre grupe. Planifikimi për zërin e pagave është marr në konsiderat nr i punonjësve të bashkisë dhe njërive. Njësitë shpenzuesë janë dy: B.M dhe NShP. Bashkia dhe nShP-ja i mbulojnë shpenzimet nga transfertat. Fondet e parashikuara për 2026-tën janë për të pagta se në 2025. Një zë i rëndësishëm është ushqimi për kopsht dhe çerdhe. Për NShP peshë më të madhe zë karburanti dhe mirëmbajtja e mjeteve. Te shpenzimet kapitale-investimet në infrastrukturë rrugore 83% mbulohen nga transfertat sektoriale, kanë ngelur pa përfunduar dy likujdime për rrugët. Te buxheti kemi detyrim ligjor për emergjencat dhe mbulohet 100% nga ministria. – dhënia e shpërblimeve për nxënësit ekselentë, për punonjësit zjarrëfikës. Kemi mbajtur rezerva nëse do të ketë ndryshime në nivelin e pagave.

Z. Klodjan Shehaj: Shërbimet e postave, si llogariten?

Z. Aleksandër Rama: e lëm si zë nëse do të duhet gjatë vitit, por nuk janë shpenzuar asnjë herë të gjitha.

Z. Qerim Ismailaj: Bëhet përlllogaritja që do mblidhesh psh 400 dhe kalohen në zëra shpenzimesh.

Z. Klodjan Shehaj: Pjesa e karburantit për ndërmarrjen si llogaritet?

Z. Qerim Ismailaj: Parashikohe si zë me periudhnjë vjeçare, por parashikimi bëhet për dy vite.

Z. Klodjan Shehaj: 1. Buxheti i Këshillit Bashkiak mund të ishte më tepër, 2. Pjesë e blerjeve të kostumeve popullore për nxënësit është shumë për ne, sepse në evenimente paguhej nga pridërit, dhe 3. Blerje kondicioneri për kineman. Dhe një sqarim për karrierën e marrjes së inerteve.

Z. Qerim Ismailaj: Garanci për rehabilitim, si kapar për t'u bër reboilitimi pas marrjes së inerteve. Kemi apikuar për marrjen e kësaj kariere, nëse nuk e bën këtë investim, merren nga ministria e linjës, por ne na intereson hapja e kësaj për rrugët e arave etj. Kinemaja ka nevoj për një sistem ngrohje. Është bër një ndryshim për blerjen e një ledëall dhe një ipod për transmetimet. Për kulturën është menduar të blihen dy kondicioner, por kjo varet se sat ë ardhura do të grumbullojmë.

Z. Klodjan Shehaj: Sistemi i kamerave është vërtetë e domosdoshme.

Znj. :Lindita Ymeraj: Ishte si zë dhe vjet dhe nuk u realizua.

Z. qerim Ismailaj: Po, ishte por po shikohet me më shumë prioritet sivjet..

Z. Lefter Rabiay: 1.Rruga e repartit ushtarak Drenovë fushë; 2. Rruga e Drenovës së re me Drenovën qendër.

Z. Armand Hasanbashaj: Dhe rruga kryesore e Drenovës.

Z. Bejkush Haxhijaj: Kanalet në fshatin Kutë kanë nevojë për pastrim dhe zhbllokim.

Z. Qerim Ismailaj: Duhet impiante pastrimi, ndihmojnë ndërmarrjen sa mundemi, por me këto pjesë meeret ujësjellës kanalizimet. Për rastet që tha profesori, jemi dakord, por duhet ta dini që çdo gjë bëhet me procedurë, por edhe sipas mundësive buxhetore të bashkisë. Do të ndjekim radhën sipas pasqyrimeve që kemi për investimet, jemi në negociata dhe me F.Sh.Zh për të realizuar disa investime. Ne këtu jemi këshilltarë të të gjitha zonave, por duhet të shohim që dhe në zonat ketu në qytet ka rrugë të pashtruara, si për shembull rruga te ish-stacioni i trenit. Pra duam të krijojmë një rrjetë qarkullimi të këtyre rrugëve. Po bëjmë një ndërthurje të shërbimit në të gjitha zonat, por gjithmonë pa e future bashkinë, në nivel makr, në borxhe. Po ruajmë të njëjtin ritëm, por kemi mangësi në mbledhjen e takasave dhe për këtë jemi të vetëdijshëm. Si fillim bëjmë hlyerjen e financimeve dhe investimeve që janë bër, pastaj shohim mundësin e bërjeve të investimeve të reja. Rruga aty është bër me çakull, por nuk mund të hyjmë në process për një rrugë lagjeje, pa bërë rrugë kryesore nëpër fshatra të tjerë. Blerja e këtyre mjeteve që kemi miratuar po na ndihmojnë, por kemi akoma mangësi.

Znj. Lindita Ymeraj: Si kanë ecur procedurat për rikonstruksionin e shkollës Ismail Klosi?

Z. Qerim Ismailaj: Kemi bër ankimim dhe është hapur drita jeshile për riaplikim, sepse herën e parë ishin 4 ofertues por nuk u kualifikua asnjë, për mungesë dokumentacionesh.

Z. Adrian Hazizaj: Ndërhyni aty ku shikohen situatat më emergjente.

Z. Qerim Ismailaj: Shpërndarja është, nëse në një rrugë bëhet rikonstruksion, ne bëjmë mirëmbajtje të rrugëve të tjera.

Z. Bejkush Haxhijaj: Për NShP kërkojmë të na paraqitet një relacion.

Z. Nexhmi Sulaj: E hedim në votim, votojnë 16 pro, 0 kundër, 0 apstenim, miratohet.

Kalojmë në pikën dymbëdhjetë dhe të fundit për rendin e ditës; Projektvendim Nr 54:Për miratimin e financimit të ndarë në tre vite. S kemi fare diskutime, hidhet në votim, votojnë 16 pro, 0 kundër, 0 apstenim, miratohet.

Mbyllet këtu mbledhja e këshillti për sot dhe për vitin 2025, faleminderit për przencën dhe festa të gëzuara!

**MBAJTËS I PROCESVERBALIT  
SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Zinaida Ahmetaj**  
